

Dr. Jusuf Osmani

ORGANET PËR ZBATIMIN E REFORMËS AGRARE DHE TË KOLONIZIMIT NË KOSOVË NDËRMJET LUFTËRAVE BOTËRORE

Organet shtetërore dhe administrative në Mbretërinë Sërbo-Kroate-Slllovene, përkatësisht Jugosllave, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose në ndonjë formë tjetër ishin të angazhuara për zbatimin e Reformës agrare dhe të kolonizimit në Kosovë dhe në viset e tjera të vendit, duke filluar prej atyre më të larta e deri tek ato më të ultat, lokale. Formimi i organeve të tilla u bë në fillim të vitit 1919. Organizimi, struktura dhe kompetencat e tjera të organeve pësuan ndryshime gjatë ekzistimit dhe funksionimit të tyre në këtë periudhë.

Pas nxjerrjes së dekretit Dispozitat paraprake për përgatitjen e reformës agrare në Mbretërinë e re të SKS të 25. II. 1919¹ dhe Urdhëresës së Këshillit Ministror të Mbretërisë së SKS të dt. 10. IX 1919, për aplikimin e pjesërishtëm të Dispozitave paraprake për përgatitjen e Reformës agrare,² që e domosdoshme themelimi i organeve shtetërore, të cilat do të zbatonin Reformën agrare dhe kolonizimin. Këto kompetenca dhe detyra iu caktuan ministrit për Politikën sociale. Me këtë përpikëj të theksohej se Reforma agrare ishte karakter social.

Organi i parë për zbatimin e Reformës agrare dhe të kolonizimit, i cili parashihej me *Dispozitat paraprake*, ishte Zyra shtetërore për reformën agrare, që iu dha për mbikëqyrje ministrit të Politikës sociale. Ajo duhej të merrej me Reformën agrare, kolonizimin e brendshëm dhe riatdhesimin e të shpërngulurve nga Amerika dhe vendet e tjera, si dhe me shpërnguljen e serbëve, kroatëve dhe slllovenëve, të cilët jetonin në shtetet e tjera. Përbajtja dhe veprimtaria e kësaj zyre duhej të rregullohej me dekretligj. Organe të tjera për zbatimin e Reformës së shpallur, Dispozitat paraprake nuk parashihnin, si dhe nuk u fol për regjimin në periudhën kaluese derisa të mos formohet zyra. Mirëpo, pa marrë parasysh këtë, menjëherë me publikimin e tyre, Sektori për Reformën agra-

¹ »Gazeta zyrtare e Mbretërisë SKS«, nr. 11/27. II 1919.

² Dr. Josip Tučković, *Agrarna reforma*, Uredbe, Naredbe i Ras-pisi. Zagreb, 1920, f. 18, 20, lib. I.

re i Ministrisë për Politikën Sociale filloi t'ua ndante tokën e pronarëve të mëdhenj nëpërmjet të besuarve të vet.³

Më vonë rezultoi përfundimi se kjo detyrë duhej t'i besohej një ministrie të veçantë dhe kështu u pa se pushteti hoqi dorë nga ideja për formimin e një zyre të posaçme për Reformën agrare. Më 2 prill 1919 emërohet ministri i Reformës agrare, por nuk merret vendimi për themelimin e një ministrie të veçantë. Këtij i jepet për detyrë dhe autorizohet për zbatimin e *Dispozitave paraprate*, të emërojnë »një numër të nevojshëm të organeve të besueshme nga shërbimi gjyqësor ose civil, të cilëve do t'u takonin gjithashtu ekspertët e besuar ekonomikë për të konstatuar e për të dhënë mendime profesionale, si dhe të gjeometrave për matjen e tokës«. ⁴ Personat e theksuar nga shërbimi gjyqësor dhe personate tjerë juridikë ishin të obliguar të kryenin detyrën e të besuarit të Reformës agrare në viset e caktuara dhe mbi bazë të Dekretligjit, instruksioneve të ministrit dhe konstatimit të shkurtër me shkrim të ekspertit ekonomik, si dhe mundësie dhe marrëveshjeve me të interesuarit dhe konsultimeve me këshillat agrare, të vendosnin për dhënien e tokës në qesim të përkohshëm. Me këtë Dekretligj ministri për Reformën agrare kishte si detyrë të mbikëqyrte punën e të besuarve dhe organizimin e punës së tërësishme, sigurimin e zbatimit të emrimit për territore të mëdha të të besuarit kryesor. Nëpërmjet këtyre organeve të gjitha ankesat duhej t'i shkonin ministrit kundër vendimeve të të besuarve, si dhe raportet dhe vendimet e të besuarve si organe të para operative.⁵

Pas kësaj në disa vise të vendit formohen Këshillat agrare si organe këshillëdhënëse të organeve shtetërore për zbatimin e Dispozitave paraprate, pastaj zyrat e posaçme për Reformën agrare, komisionet agrare fshatare, detyra e të cilëve ishte e kufizuar në ndërmjetësimin me qëllim të arritjes së marrëveshjeve për pagesën e kompensimit të pronësisë së tokës, për punimin e tokës e të tjera, kurse në Dalmaci, Maqedoni, Kosovë dhe në të Malit të Zi në fillim nuk u formuan kurrfarë organesh për Reformën agrare, por të gjitha punët i kryente pushteti administrativ (policor).⁶

Të besuarit agrarë dhe të besuarit kryesorë agrarë, bashkë me personat tjerë të caktuar (që përbënin drejtoratet), luanin rolin e organit operativ të ministrit të Reformës agrare. Kontrollin e punës së këtyre organeve gjatë vitit 1919 e bëri vetë ministri me një numër të vogël të nëpunësish, përkatësisht nëpërmjet organeve përkatëse të qeverive krahinore, mirëpo, nga dokumentacioni arkivor shihet se nga gushti i vitit 1919 figuron Ministria e Reformës Agrare, ndonëse ende nuk ishte formuar zyrtarisht. Përkitazi me këtë, kësaj Ministrie i janë dërguar raporte nga i besuari i lartë i Refor-

³ Dr. Milivoje Eriq, *Agrarna reforma u Jugoslaviji 1918—1941*, Sarajevë, 1958, f. 298.

⁴ Naredba Ministarskog saveta od 10. IV 1919, o delimičnom izvođenju Prethodnih odredaba za pripremu agrarne reforme od 25. II 1919, neni 5; Dr. Tučkoviq, v. c. f. 19; Dr. M. Eriq, v. c. f. 300.

⁵ Dr. M. Eriq, v. c. f. 298.

⁶ Dr. M. Eriq, v. c. f. 303.

mës agrare në Shkup ose anasjelltas,⁷ si dhe kryeshëfi i Ministrisë së Reformës Agrare mbante korrespondencë me ministritë tjera etj.⁸ Problematika e ndërlikuar, punët e mëdha dhe bindja se puna e filluar nuk do të mund të kryhej shpejt, në fillim të vitit 1920 diktuau nevojën e formimit të administratës së posaçme agrare.⁹ Me Dekretligjin nr. 2119 të 12. II 1920 u themelua Ministria e Reformës Agrare e Mbretërisë Sërbo-Kroate-Slllovene me seli në Beograd.¹⁰ Detyrë e kësaj Ministrie ishte të hartonte propozimet për ligje, dekretligje dhe urdhëresat për Reformën agrare dhe nëpërmjet organeve të veta t'i ekzekutonte; pastaj të organizonte dhe të udhëhiqte punët rreth ndarjes së tokës, kolonizimit, repatrimin; marrjes së pronave të mëdha bujqësore, pylltare në duart e shtetit; të udhëhiqte punët e zgjedhjes dhe rregullimit të marrëdhënieve kolonizuese, çifligare e të tjera, pastaj të kujdesej në përgjithësi për ngritjen e bujqësisë.¹¹ Detyra e Ministrisë së Reformës Agrare ishte e dyfishtë: likuidimi i marrëdhënieve çifligare dhe i kolonizimit.¹²

Gjatë vitit 1920 themelohen drejtoratet agrare dhe zyrat agrare krahinore, kështu që plotësohet sistemi i organeve shtetërore administrative kompetente për zbatimin e Reformës agrare dhe të kolonizimit në Mbretërinë e SKS-së. Ato përbëheshin prej drejtorateve agrare të qarkut, si organe të shkallës së parë, drejtorateve agrare (Drejtorati kryesor i Reformës agrare), si organe të shkallës së dytë, dhe Ministrisë së Reformës Agrare, si organ suprem qendror shtetëror administrativ për këtë veprimtari.

Ministria e Reformës Agrare, si organ më i lartë, përbëhej nga:¹³

1. *Seksioni i përgjithshëm* me këto sektore ose nënseksione: a) Kabineti i Ministrisë, i cili udhëhiqte tërë korrespondencën, përgatiste përgjigjet në interpelacion dhe i kryente të gjitha punët që ia kishte besuar ministri; b) Sektori administrativo-personal, i cili udhëhiqte librat e protokolit, arkivin dhe inventarin; c) Sektori agraro-teknik, detyrë e të cilit ishte të organizonte, të udhëhiqte dhe të kontrollonte të gjitha punët gjeodete gjatë zbatimit të Reformës agrare dhe të kujdesej, që këto punë si pjesë përbërëse të matjes shtetërore të tokës që me kohë dhe në mënyrë të saktë të kryhen dhe të kujdesej për përpilimin e evidencave për matjen e tokës përkitazi me Reformën agrare. Ky sektor manipulonte me aparatet, hartat dhe elaboratet e tjera të hartuara dhe me bibliotekën. Udhëhiqte edhe statistikën e zbatimit të reformës agrare. Në kuadrin e këtij sektori hynin edhe këto nënsektore: gjeodet, ndërtime dhe statistikor.¹⁴

⁷ Arkivi i Jugosllavisë (AJ) — Ministria e Reformës Agrare (MAR), 96—1—4, 96—24—77.

⁸ *E njejtë.*

⁹ Dr. M. Eriq, v. c. 303.

¹⁰ Gazeta zyrtare Mbretërisë SKS, nr. 36, 18. II. 1920.

¹¹ Uredba o ustrojstvu Ministarstva za agrarnu reformu Kraljevine SHS, neni 2. («Gaz. zyrtare» e Mbretërisë SKS, nr. 36/1920); Dr. Tučković, v. c. f. 4; Dr. M. Eriq, v. c. f. 303.

¹² «Socijalistička Zora» nr. 53, 1. VIII. 1920, Shkup.

¹³ Almanah Kraljevine SHS, I, 1921—1925, Zagreb, f. 66—67; Almanah Kraljevine SHS II, 1927—1928, Zagreb.

¹⁴ Agrarna reforma II; Dr. M. Eriq, v. c. 304.

2. *Seksioni agrar* përgadiste projektet ligjore për rregullimin e Reformës agrare, udhëhiqte punët rreth likuidimit të pronave të mëdha dhe marrjes së tyre nën mbikëqyrje dhe administrim shtetëror, pastaj punët rreth zgjidhjeve të marrëdhënieve çifligare e të tjera. Ky seksion ndahej në këto nënseksione: nënseksionin juridik, nënseksionin e marrëdhënieve çifligare, nënseksionin mbikëqyrës, administrues dhe për likuidimin e pronave të mëdha dhe në nënseksionin financiar.

3. *Seksioni i kolonizimit* kujdesej për krijimin dhe përparimin e ekonomive të vogla të reja. Udhëhiqte të gjitha punët rreth sigurimit të nevojshëm të tyre për kolonizim dhe për krijimin e kushteve dhe të mjeteve për zhvillimin dhe përparimin e tyre. Ky seksion kishte këto nënseksione: a. Nënseksionin për kolonizimin e brendshëm dhe riatdhësim, detyrë e të cilit ishte »të bënte shpërnguljen nga viset tepër të popullzuara dhe të zhveshura në viset ku kishte tokë të përshtatshme për kolonizim, si dhe të ndihmonte ardhjen e kolonistëve që jetonin jashtë vendit dhe t'i vendoste në viset e përshtatshme për kolonizim« dhe b. Nënseksionin për kooperativizëm, që kujdesej rreth ngritjes ekonomike të kolonistëve dhe personave të tjerë, të cilët nëpërmjet Reformës agrare kishin marrë tokë, sidomos nëpërmjet organizatave kooperativiste të ngritnin kulturën në fshat.

4. *Sektori i financave* kryente të gjitha punët e natyrës financiare.

Me Dekretligjin për themelimin e Ministrisë »me qëllim të ndryshimit të marrëdhënieve agrare dhe udhëheqjen e shpejtë të punëve«¹⁵ parashiheshin si organe ekzekutive drejtoratet agrare me seli në Zagreb, Lubjanë, Split, Sarajevë, Cetinë, Novi-Sad dhe Shkup, ndërsa si organe të shkallës së parë të këtyre drejtorateve, ato të qarkut dhe zyrat agrare të rrethit, pastaj të besuarit dhe komisionet. Në Shkup, Cetinë dhe Split quheshin drejtorate agrare kryesore.

Për të ashtuquajturën »Serbi Jugore«, ku bënin pjesë Kosova, Maqedonia dhe një pjesë e Malit të Zi, si organ i shkallës së dytë për zbatimin e Reformës agrare ishte themeluar *Drejtorati kryesor i reformës agrare* me seli në Shkup, në bazë të Dekretligjit mbi organizimin e Ministrisë së Reformës Agrare të 12. II 1920, neni 27, kurse si *Drejtorat suprem i reformës agrare* u themelua në bazë të dispozitave të nenit 4 të Ligjit mbi kolonizimin e viseve jugore të 11. VI 1931 dhe me ndryshimet dhe plotësimet e po këtij ligji të 11. XII 1931 dhe 24. VI 1933, me qëllim që kryhej kolonizimi.

Detyrë e këtij Drejtorati ishte që në territorin në të cilin ishte kompetent dhe funksiononte t'i kryente punët rreth ndarjes së tokës, kolonizimit, ndarjes së tokës kolonistëve, të kontrollonte udhëheqjen dhe të bënte mbikëqyrjen shtetërore mbi tokat e pronarëve të mëdhenj, të kujdesej për ngritjen e bujqësisë në përgjithësi dhe të hartonte projektet dhe propozimet për punët e Reformës agrare, të bënte revizionin e tokave të begut dhe të uzurpimeve, të ven-

¹⁵ Uredba o ustrojstvu Ministarstva za agrarnu reformu, neni 29; Dr. M. Eriq, v. c. 304.

doste për kontestet ndërmjet çifçiut dhe beut, sidomos në pronat çifligare dhe tokat e beut, pastaj për të drejtat e regjistrimit dhe të përmirësimit të regjistrimit të familjeve të caktuara në tokat çifligare, të vendoste për të drejtat e marrëdhënieve çifligare bejlere e të tjera.¹⁶

Drejtoratet agrare të qarkut u themeluan gjithashtu me Dekretligjimi mbi themelimin e Ministrisë së Reformës Agrare të 12. II 1920 dhe me Ligjin mbi kolonizimin e viseve jugore të 11. VI 1931, me ndryshimin dhe plotësimin e tij të mëvonshëm. Në territorin e Kosovës u themeluan këto Drejtorate agrare: në Pejë, Prishtinë, Mitrovicë, Vuçiternë, Gjakovë dhe Prizren. Me Ligj më 1931 në vend të Drejtoratit agrar në Prishtinë formohet ai në Ferizaj, si dhe në vend të drejtorateve agrare të qarkut ato quhen drejtorate agrare.

Drejtorati agrar i Qarkut në Prishtinë, përkatësisht i Ferizajt përfshinte këto rrethe: të Nerodimës, Graçanicës, Gjilanit dhe të Kaçanikut; Drejtorati agrar i qarkut të Mitrovicës ka përfshirë këto rrethe: të Mitrovicës, Shtavicës dhe Dezhevës. (Këta dy të fundit jashtë Kosovës); Drejtorati agrar i qarkut në Pejë: të Pejës, Istogut, Andrijevicës dhe të Beranit. (Këta dy të fundit jashtë Kosovës); Drejtorati agrar i qarkut në Vuçiternë: të Vuçiternës, Drenicës dhe Llapit; Drejtorati agrar i qarkut në Gjakovë ka përfshirë rrethin e Gjakovës dhe të Podrimës; Drejtorati agrar i qarkut në Prizren ka përfshirë rrethin e Sharrit, të Podgorës dhe të Gorës. (Në këtë të fundit nuk ka pasur reformë agrare).

Në këtë mënyrë u kompletua rrjeti i organeve për zbatimin e Reformës agrare dhe të kolonizimit në territorin e Kosovës.

Detyrë e drejtorateve agrare të qarkut, si institucione të shkallës së parë në përbërjen e Drejtoratit kryesor, përkatësisht suprem të Reformës agrare në Shkup, ishte t'i kryenin të gjitha punët rreth zbatimit të Reformës agrare dhe kolonizimit, përveç atyre që në bazë të dispozitave ligjore ekzistuese në fuqi ishin nën kompetencën e organeve më të larta, Drejtoratit kryesor (suprem) të Reformës agrare në Shkup dhe Ministrisë së Reformës Agrare, përkatësisht Ministrisë së Bujqësisë.

Në kompetencën e drejtorateve agrare të qarkut bënin pjesë këto punë: grumbullimi dhe rregullimi i materialit të nevojshëm statistikor për pronat e mëdha dhe të interesuarit agrarë, dhënia e propozimeve Drejtoratit suprem (kryesor) të Reformës agrare për ndarjen definitive të tokës dhe kolonizimit, udhëheqja e atyre çështjeve dhe marrja e vendimeve se cilat pjesë të pronave të mëdha merren për qëllim të Reformës agrare, të cilat u lejohen si maksimum i ngushtë ose i gjerë pronarëve të mëdhenj ose për qëllime të sigurimit të industrisë ushqimore dhe të institucioneve të ndryshme bujqësore, marrja e vendimeve për ndarjen e përkohshme individuale të tokës së pronave të mëdha në disa komuna, për dhënien e tokës të interesuarve në qesim të përkohshëm, si dhe marrja e vendimeve të tjera rreth zbatimit të Reformës agrare, udhëheqja

¹⁶ Almanah Kraljevine SHS, 1927—1928, f. 67.

e evidencave të pjesëve të ekspropriura të pronave të mëdha dhe kujdesi për bartjen e tyre kadastrale të pronarët e rinj.¹⁷

Sipas Ligjit, programin e kolonizimit e hartuan drejtoratet agrare për territorin e vet në afat deri më 1 janar për çdo vit dhe atë ia dërguan Drejtoratit të lartë agrar në Shkup, i cili, mbi bazë të programeve që mori hartoi propozimin për programin e përgjithshëm të kolonizimit më së largu deri më 1 mars dhe, së bashku me të gjitha elaboratet, ia dërgoi Ministrisë së Bujqësisë, e cila, në mbështetje të propozimeve dhe shënimeve të tjera, si dhe në suazën e mjeteve buxhetore, hartoi deri në fillim të vitit buxhetor programin definitiv të kolonizimit për vitin vijues buxhetor.

Drejtoratet agrare të qarkut paraqitnin organin e shkallës së parë dhe ekzekutiv për zbatimin e Reformës agrare dhe të kolonizimit dhe drejtpërsëdrejti i nënshtroheshin Drejtoratit kryesor (suprem) të reformës agrare në Shkup, kurse instancën e shkallës së tretë në sistemin e institucioneve për zbatimin e reformës agrare e paraqiste Ministria e Reformës agrare, përkatësisht Ministria e Bujqësisë në Beograd.

Në mbështetje të Ligjit mbi kolonizimin e viseve jugore për Drejtoratin e lartë agrar në Shkup dhe 12 drejtoratet agrare në të ashtuquajturat »Viset jugore« u përcaktuan këto vende të punës: 140 nëpunës të plotësuar sipas Ligjit mbi nëpunësit dhe 30 vende të nëpunësve teknikë kontraktues, teknikë të përhershëm me mëditje, nëpunës me mëditje, punëtorë ndihmës me mëditje dhe shoferë me mëditje. Prej tyre, sipas formacionit: 1 i besuar i lartë i Reformës agrare, 3 ndihmës të të besuarit të lartë të Reformës agrare, 4 inspektorë, 5 këshilltarë, 4 sekretarë, 6 ndihmës të lartë, 8 ndihmës, 11 referentë agrarë, 10 gjeometra të lartë, 1 revizor i lartë, 12 gjeometra, 7 ndihmës sekretarë, 13 revizorë, 5 nëpunës teknikë, 4 punëtorë të shkrimtores, 1 arkivist kryesor, 4 arkivistë, 13 nëpunës të arkivit, 6 praktikantë të ndryshëm, 14 nëpunës, 8 ndihmës, 30 nëpunës kontraktues, teknikë me mëditje, nëpunës me mëditje, ndihmës me mëditje dhe shoferë me mëditje.

Punët rreth përcaktimit të objekteve dhe të subjekteve të Reformës agrare aty për aty i udhëhiqnin drejtoratet agrare nëpërmjet përfaqësuesve të vet ose komisioneve, por më parë konsultoheshin me këshillat agrare të atyre vendeve. Drejtoratet nuk ishin të detyruara t'i miratonin patjetër mendimet e këshillave.

Në krye të Drejtoratit agrar të qarkut ishte i besuari agrar. Këto drejtorate në Kosovë funksionuan deri më 1941, përveç Drejtoratit agrar të Vuçiternës, i cili u suprimua më 1936 dhe iu bashkua Drejtoratit agrar të Mitrovicës dhe atij të Gjakovës, i cili pastaj iu bashkua Drejtoratit agrar të Pejës.

Mirëpo, disa dispozita ligjore në fuqi për formimin dhe punën e organeve për zbatimin e Reformës agrare dhe të kolonizimit ishin jo të plota dhe joprecize, prandaj mundësuan keqpërdorime të ndryshme të organeve agrare. Gazeta e atëhershme »Demokratija« njofton se në drejtoratet agrare shpesh rreth zbatimit të reformës

¹⁷ Mr. Jusuf Osmani, *Arhivska građa o agrarnoj reformi i kolonizaciji na Kosovu, 1918—1941* (punim i doktoranturës), Lubjanë, 1985, f. 158.

agrare dhe kolonizimit janë bërë korupcione të ndryshme, kështu që është krijuar pakënaqësi. Nëpunësit e tyre s'kishin kurrfarë kualifikimi moral, shkollor etj.¹⁸ Reformës agrare e kritikoi sidomos nga popullsia vendëse, sepse, siç thuhet në një dokument: »... se atyre po iu duket se toka po u jepet të gjithë kolonistëve nga viset e ndryshme e atyre këtu jo«.¹⁹

Në Kosovë, Maqedoni dhe në një pjesë të Malit të Zi, ku ende mbretëronin marrëdhëniet feudale, zgjidhja e kontesteve rreth dhënies së rëntës së përkohshme parashihej me Urdhëresën e ministrit të Reformës agrare nr. 3659 të 12. VIII 1919.²⁰ Këtë detyrë e kryenin *komisionet agrare komunale* prej tre anëtarësh: një nga radhët e ish — çifligsahibinjtë dhe ish — çifcinjtë dhe kryetarit të komunës ose personit të autorizuar, i cili kishte rolin e kryetarit të komisionit. Këto komisione nuk zgjaten shumë dhe nuk kishin ndikim të madh në rrjedhat e Reformës.²¹ Komisionet agrare nëpër komuna duhej t'i kontrollonin e t'i revidonin regjistrat e të interesuarve agrarë, të cilët kishin marrë tokën në qesim të përkohshëm, i revidonin regjistrat e vullnetarëve për ndarjen e tokës, pastaj pronat e goditura nga Reforma agrare dhe të konstatonin se ç'duhej flakur në punën e deriatëhershme rreth Reformës agrare.

Me Dekretligjin mbi kolonizimin e viseve të reja jugore të vitit 1920,²² përkatësisht Ligjin mbi kolonizimin e viseve të reja jugore të vitit 1922,²³ formohen *komisionet e rrethit*, ekskluzivisht për nevoja të kolonizimit. Në përbërjen e komisionit hynin: personi i caktuar nga Ministria e Reformës Agrare, përkatësisht organi i tij kryesor, nëpunësi policor i rrethit përkatës, që e caktonte prefekti i rrethit, kryetari ose kryeplaku i komunës përkatëse, i cili ishte i detyruar t'i jepte komisionit të gjitha informatat për rrethanat në rajonin e tij përkitazi me marrëdhëniet pronëso-ro-juridike, ekonomi ose pylltari, si dhe gjeometri, që ishte në shërbim të Ministrisë së Reformës Agrare ose në shërbim të shtetit dhe mjeku. Kryetarin e komisionit e caktonte Ministria. Me Ligjin mbi kolonizimin e viseve jugore të vitit 1931 parashiheshin gjithashtu të ashtuquajturat *komisione për kufizimin e tokës*. Këto i caktonte i besuari i lartë i Reformës agrare në Shkup, të cilat bënë aty për aty ndarjen dhe kufizimin e tokës. Në përbërjen e tyre ishin: kryetar i komisionit ishte nëpunësi agrar, të cilin e caktonte i besuari i lartë i Reformës agrare, referenti profesional i bujqësisë ose i ndonjë shërbimi tjetër të shtetit, kurse në mungesë të tij edhe gjeometri civil i betuar dhe, sipas nevojës, edhe referenti profesional për shëndetësi, pylltari dhe hidroteknikë.²⁴ Në punën e komisionit për kufizimin e tokës,

¹⁸ »Demokratija«, shtator 1924, Beograd.

¹⁹ AJ, Centralni press biro (CPB), f. 38—90—40.

²⁰ Dr. J. Tučković, v. c. f. 232—236.

²¹ Dr. M. Eriq, v. c. f. 307.

²² Uredba o naseljavanju novih južnih krajeva, prej 21. IX 1920, »Gaz. zyrta re e Mbretërisë SKS« nr. 232, 20. X 1920.

²³ Zakon o naseljavanju južnih novih krajeva, prej 22. V 1922, »Gaz. zyrta re e Mbretërisë SKS« nr. 27, 9. XII 1922.

²⁴ Zakon o naseljavanju Južnih krajeva, nr. 35200 prej 11. VI 1931, »Gaz. zyrta re e Mbretërisë së Jugosllavisë« nr. 134, 17. VI 1931; Dr. Milovan Obradović, *Agrarna reforma i kolonizacija na Kosovu 1918—1941*, Prishtinë, 1981, f. 139.

me ftesën e kryetarit të komisionit duhej të merrte pjesë gjithnjë kryetari, përkatësisht kryeplaku ose këshilltari i komunës ose i fshatit përkatës, i cili nënshkruante procesverbalin e komisionit për kufizimin e kryer.

Gjatë punës komisioni udhëhiqte procesverbalin për punën e vet dhe hartonte projektin e tokës së kufizuar me regjistrit të ngastrave. Pas kryerjes së punëve komisioni ia dorëzonte Gjyqit komunal kompetent projektin e tokës së kufizuar me regjistrin e ngastrave në shikim të interesuarit agrar, në afat prej 15 ditësh dhe po këtë ditë e shpallte në mënyrën e zakonshme, që projekti me regjistrin e parcelave i është shpallur të interesuarëve për shikim. Lajmërimi i bërë në këtë mënyrë konsiderohej si lajmërim i kryer i të interesuarve. Për punën e komisionit, përkatësisht kundër vendimit të tij të interesuarit, sipas Dekretligjit dhe Ligjit të vitit 1922, kanë mundur t'i ankohen Ministrit të Reformës agrare në afat prej 15 ditësh, kurse sipas Ligjit të vitit 1931 të besuarit të lartë të Reformës agrare. Mirëpo, gjyqi shpesh nuk e bënte shpalljen e tyre ose këtë e bënte në mënyrë ilegale, kështu që personat të cilëve u ishte përfshirë toka në kompleksin e kufizuar për Reformën agrare nuk ishin informuar, nuk dinin për këtë, prandaj nuk ankoeshin fare dhe toka u merrej. Për këtë dëshmojnë shumë ankesa. Psh. ,deklarata e Nuhi Xhemail Abdullahut nga Prizreni, i cili deklaroi në ankesën e vet të 5. VIII. 1933 se Gjyqi i shkallës së parë në Prizren e ka refuzuar pasi ai nuk është ankuar, por ai thekson se nuk iu ka komunikuar procesverbali dhe nuk ka ditur fare për të.²⁵

Me Dekretligjin e vitit 1920 dhe Ligjin e vitit 1922 u shpall edhe formimi i *Këshillit këshilldhënës për kolonizim*. Ministria e Reformës Agrare, përkatësisht Ministria e Bujqësisë e formoi këtë këshill me qëllim që të bëjë në mënyrë sa më efikase dhe të drejtë kolonizimin dhe t'u ndihmojë kolonistëve. Sipas këtij Dekretligji dhe Ligji, anëtarë të Këshillit ishin: shefi i sektorit për kolonizim dhe riadhesimi i Ministrisë së Reformës Agrare, të deleguarit e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ujërave, të deleguarit e Ministrisë së Punëve të Brendshme, të Ministrisë së Politikës Sociale, të Ministrisë së Shëndetit Popullor, të Ministrisë së Pyjeve dhe të Xehëve, të Ministrisë së Komunikacionit dhe një numër i nevojshëm përsosnash që i caktonte ministri i Reformës agrare. Kurse sipas Ligjit të vitit 1931 anëtarë ishin: ndihmësi i ministrit të Bujqësisë, i besuari i lartë i Reformës agrare në Shkup, shefi i sektorit për kolonizimin e viseve jugore, të deleguarit e Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Ushtrisë dhe të Detarisë, Ministrisë së Politikës Sociale dhe të Shëndetit Popullor, Ministrisë së Pyjeve dhe të Xehëve, Ministrisë së Ndërtimitarinë dhe Ministrisë së Financave, si dhe personat e tjerë që i caktonte ministri i Bujqësisë. Kryetar i Këshillit këshilldhënës për kolonizim ishte ndihmësi i ministrit të Bujqësisë, kurse anëtarë më i ri i Këshillit nga Ministria e bujqësisë kryente në të njëjtën kohë edhe detyrën e udhëheqësit të Këshillit mbikëqyrës.

²⁵ Arkivi i Kosovës, Prishtinë (AK), Gjyqi i rrethit — Prizren, K. 1—58 1940.

Detyrë e Këshillit këshilldhënës ishte që sipas kërkesës dhe nevojës të jepte mendime profesionale me qëllim të krijimit të kushteve të përshtatshme për kolonizimin dhe ngritjen kulturo-ekonomike të të interesuarve agrarë derisa të bëheshin pronarë të tokës së marrë, të jepte mendimin për planin vjetor për kolonizimin etj.²⁶

Drejtorati kryesor me seli në Shkup, sipas nevojës formonte komisione që caktonin aty për aty komplekse tokash për popullëzim. Këto komisione, sipas raportit të Drejtoratit të Shkupit, formoheshin atëherë kur kërkonin nëndrejtoratet. Komisionet kishin disa anëtarë: një anëtar që e caktonte prefekti, një anëtar që e caktonte Drejtorati agrar dhe një qytetar, të cilin e zgjidhnin këta të dy. Për këtë punë duhej të informoheshin titullarët e policisë nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme. Ndërkaq, drejtorateve agrare duhej t'u sigurohej kredia deri në 15.000 dinarë për shpenzimet rreth këtyre komisioneve.²⁷

Si organe ndihmëse të administratës agrare dhe të organeve shtetërore ishin edhe mbikëqyrësit e kolonive — vendbanimeve. Ata u emëruan dhe u shkarkuan disa herë nga detyra. Këto organe shpërbleheshin mirë dhe gjithnjë përfaqësonin interesat e asaj partie të regjimit të cilën e përkrahte Ministria e Reformës Agrare.²⁸

Meqë në krahasim me kolonizimin Reforma agrare u zbatua ngadalë dhe nuk u krye përfundimisht deri në fund të ekzistimit të Mbretërisë jugosllave (në prill të vitit 1941), u bënë ndryshime në organizimin dhe titullimin e organeve shtetërore për zbatimin e tyre. Në një kohë është paraparë ndryshimi dhe likuidimi i administratës agrare, mirëpo, ajo gjithnjë shtyhej.

Në suazën e ndryshimeve të mëdha në organizimin shtetëror, pas vënies së diktaturës monarko-fashiste të gjashtë janarit të vit. 1929 dhe centralizimit gjithnjë më të madh të administratës, u bë ndarja administrative teritoriale e shtetit në nëntë banovina. Me themelimin e banovinave (1929—1941) në bazë të Ligjit mbi emërimin dhe ndarjen e shtetit në njësi administrative, territori i Kosovës i takoi Banovinës së Vardarit, të Moravës dhe të Zetës.²⁹ Në kuadër të ndryshimeve të mëdha në organizimin e administratës shtetërore u bënë ndryshime edhe në organizimin e organeve shtetërore administrative, kompetente për Reformën agrare dhe kolonizim, kështu që u likuiduan organet e administratës së veçantë për këto çështje dhe hyn në sistemin unik të organeve të përgjithshme administrative: Prefektura e rrethit, Drejtoria e Banovinës, e Ministrisë.³⁰ Në bazë të Dekretligjit mbi rregullimin e Ministrisë

²⁶ Uredba o naseljavanju novih južnih krajeva od 1920; Zakon o naseljavanju novih južnih krajeva pre 1922; Zakon o naseljavanju južnih krajeva, 1931.

²⁷ Dr. Hakif Bajrami, *Rrethanat shoqërore dhe politike në Kosovë më 1918—1941*, Prishtinë, f. 154.

²⁸ Dr. M. Eriq, v. c. 310—311.

²⁹ Zakon o pozivu i podeli Kraljevine na upravna područja, »Gaz. zyr-tare e Mbretërisë SKS« nr. 233—XCVI e 5. X. 1929.

³⁰ Nikola Nikoliq, *Formiranjë arhivskih fondova o agrarnoj reformi i kolonizaciji vršenoj na području današnje SAP Vojvodine u periodu 1919—1941*, »Arhivist« 1—2/1982, Beograd, f. 53.

së Bujqësisë nr. 21802/I të 3. VII. 1929,³¹ nenit 14, thuhet se kur Dekretligji hyn në fuqi »pushon të vlejë Dekretligji mbi rregullimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ujërave të 8. VII. 1919 dhe me plotësimin e tij të 20. IV. 1920 dhe Dekretligjit mbi rregullimin e Ministrisë së Reformës Agrare të 17. II. 1920«. Edhe pse në këtë Dekretligj nuk thuhet se suprimohet Ministria e Reformës Agrare, konstatohet se Dekretligji mbi rregullimin e Ministrisë së Reformës Agrare përfundon të jetë në fuqi, në të vërtetë paraqet dispozitën mbi suprimimin e kësaj Ministrie, ku kompetencat dhe detyrat bartën në Ministrinë e Bujqësisë, në seksionin për Reformën agrare.³² Me Dekretligjin e lartëpërmendur mbi rregullimin e Ministrisë së Bujqësisë të vit. 1929 drejtoratet agrare të qarkut dhe zyrat agrare krahinore të deriathershme në territorin e Mbretërisë SKS e ndërrojnë emrin e tyre në »zyret agrare« Ligdhënësi thekson se »ndërrohet titulli«, që na dëshmon se nuk themelohet diçka e re, por vetëm e ndërrojnë emrin e organit.³³ Edhe pas Diktaturës së 6 janarit, një kohë funksionon Ministria e Reformës Agrare dhe drejtoratet agrare të qarkut. Kjo ministri figuron në dokumentacionin arkivor deri në prill të vitit 1929, e cila, së bashku me Ministrinë e Bujqësisë, nxjerr disa dekrete, po ashtu figurojnë edhe drejtoratet agrare të qarkut.³⁴ Pastaj i merr kompetencat Ministria e Bujqësisë.³⁵

Me Ligjin mbi Drejtoratin e Banovinës³⁶ formohet seksioni i bujqësisë, kurse në kuadrin e tij sektori për punë agraro-juridike. Detyra e këtij seksioni ishte zbatimi i Reformës agrare dhe i kolonizimit sipas dispozitave ligjore në fuqi. Me nenin 49 të këtij Ligji suprimohen drejtoratet agrare në Lubjanë, Zagreb, Split, Sarajevë, Novi-Sad dhe Shkup, kurse punët e tyre kalojnë në drejtoratet e Banovinës mbretërore. I besuari i lartë i Reformës agrare në Shkup udhëhiqte të gjitha punët e Reformës agrare në territorin e Banovinës së Vardarit dhe në disa pjesë të Banovinës së Moravës dhe të Zetës, të cilat ishin në kompetencën e drejtorateve agrare të qarkut, përkatësisht Drejtoratit agrar të Shkupit, dhe i cili si referent drejtpërsëdrejti i nënshtrohej banit. Zyrat agrare, përkatësisht drejtoratet agrare të qarkut suprimohen, kurse punët e tyre kalojnë në kompetencën e prefekturave përkatëse të rrethit, në ato qendra ku më parë ishin drejtoratet agrare të qarkut.

Sektori agraro-juridik kishte këto shërbime: agraro-juridik, kolonizues, financiar dhe likuidues. Këto vareshin drejtpërsëdrejti nga bani. Për shkak të specifitetit dhe veprimtarisë së madhe, nevoja për ndarjen dhe pavarësinë e tyre nga drejtoratet bujqësore u paraqit që në fillim të themelimit të drejtorateve të Banovinës,

³¹ »Gaz. zyrtare e Mbretërisë së Jugosllavisë« nr. 185—LXXVI e 10. VIII. 1929.

³² Nikola Nikoliq, v. c., f. 56.

³³ E njëjtë.

³⁴ »Gaz. zyrtare e Mbretërisë SKS« nr. 30/30. II. 1919, nr. 61/14. III. 1929, nr. 100/29. IV. 1929.

³⁵ »Gaz. zyrtare e Mbretërisë SKS« nr. 114/17. V. 1929.

³⁶ »Gaz. zyrtare e Mbretërisë së Jugosllavisë« nr. 261—CV/7. XI. 1929.

mirëpo kjo bëhet më vonë³⁷ Lidhur me këtë, me rastin e përvjetorit të Drejtoratit të Banovinës, bani i Banovinës së Vardarit — La-ziq, pat deklaruar se me Ligjin mbi Drejtoratin e Banovinës suprimohen të gjitha institucionet agrare. Të gjitha punët agrare i dorëzohen të besuarit të lartë agrar në Shkup. Ka filluar riorganizimi i institucioneve agrare dhe caktimi i referentëve agrarë nëpër disa rrethe.³⁸

Nga dokumentet arkivore të hulumtuara për këtë qëllim hamim vetëm në nënseksionin për çështje agraro-juridike në Vuçiternë, si dhe në dispozitën ligjore »Nënseksioni agraro-juridik në Vuçiternë«.³⁹

Kushtet specifike dhe qëllimet e Reformës agrare në Kosovë, Maqedoni dhe një pjesë të Malit të Zi kushtëzuan formimin e organeve të posaçme për likuidimin e marrëdhënieve feudale, kolonizimin dhe rregullimin e të drejtave pronësore.⁴⁰ Për këto punë, duke u mbështetur në Ligjin mbi kolonizimin e viseve jugore nr. 35200 të 11. VI. 1931,⁴¹ formohen Drejtorati i lartë i Reformës agrare në Shkup (në vend të ish — Drejtoratit kryesor) me 12 drejtorate agrare (në vend të ish — drejtorateve agrare të qarkut).⁴² Në Kosovë drejtoratet agrare mbesin prapë me seli në Pejë, Prizren, Gjakovë, Vuçiternë, Mitrovicë dhe Ferizaj (në vend të atij në Prishtinë). Gati të gjitha drejtoratet e Reformës agrare në territorin e Kosovës funksionojnë deri në vitin 1941, përveç Drejtoratit agrar në Gjakovë, i cili suprimohet më 1937 dhe i bashkangjitet Drejtoratit agrar në Pejë⁴³ dhe Drejtoratit agrar në Vuçiternë i cili po këtë vit i bashkangjitet Drejtoratit agrar në Mitrovicë.

Në bazë të Ligjit mbi kolonizimin e viseve jugore u themeluan edhe komisionet për kufizimin e tokës dhe këshilli këshilldhënës. Për përbërjen e tyre është folur më lart.

Punët rreth likuidimit financiar të Reformës në pronat e mëdha me të drejtë përparësie për blerjen e tokës, të cilën e merrnin subjektet agrare, iu besuan Bankës së privilegjuar agrare në Beograd. Kjo bankë u themelua më 1929 në bazë të Ligjit mbi Bankën e privilegjuar agrare⁴⁴ si institucion qendror për kreditë bujqësore. Përveç punëve të rregullta bankiere nga fushëveprimtaria e saj, banka kryente edhe punë speciale në llogari të shtetit, siç ishin likuidimi financiar i reformës në pronësitë e mëdha duke filluar prej vitit 1933 dhe likuidimi i borxheve të bujqve prej vitit 1936.⁴⁵ Themelimin e kësaj banke e kritikon gazeta e atëhershme »Proleter«, organ i Komitetit qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë, ku

³⁷ Sanja Sariq, *Kriterijumi za formiranje fondova nastali u vezi sa rješavanjem agrarnog pitanja u B i H (1878—1949)*. Koreferat në Këshillin federativ të punëtorëve arkivorë të Jugosllavisë, nr. 1—3. XI. 1982.

³⁸ »Politika« nr. 8048 e 3. X. 1930, Beograd.

³⁹ »Gaz. zyrtare e Mbretërisë Jugosllave«, nr. 79/2. IV. 1930.

⁴⁰ Dr. M. Erić, v. c. 320.

⁴¹ »Gaz. zyrtare e Mbretërisë së Jugosllavisë« nr. 134 të 17. VI. 1931.

⁴² AJ, CPB 38—505—657, »Srpske novine«, 29. X 1931, Budušin.

⁴³ »Kosovske novine« nr. 7 e dt. 26. II 1937, Mitrovicë.

⁴⁴ »Gaz. zyrtare e Mbretërisë së Jugosllavisë« nr. 94/22. IV. 1929.

⁴⁵ Olga Giler, *Formiranje arhivskih fondova na nivou federacije iz oblasti bankarstva*, »Arhivist« 1—2/1982, Beograd.

thekson se nuk është themeluar me qëllim të zhdukjes së marrëdhënieve gjysmëfeudale, por për të siguruar pagesën e pronarëve të mëdhenj për tokën e çifçinjve etj.⁴⁶ Sipas Ligjit të 25. II. 1930, kjo bankë autorizohet të marrë pjesë në komision për parcelimin e pronave të mëdha dhe të blejë tokë për qëllime të kolonizimit, kështu që pati rol të posaçëm për likuidimin e borxheve të Reformës agrare.⁴⁷ Nga dokumentet arkivore shihet se kjo bankë lejonte kredi për blerjen e tokave nga popullsia vendëse.⁴⁸ Edhe Banka hipotekare ishte e angazhuar në zbatimin e Reformës agrare.

Për zbatimin e Reformës agrare dhe për t'u dhënë ndihmë kolonistëve qenë formuar kooperativat (bashkësitë) agrare nëpër Kosovë dhe Lidhja e kooperativave (bashkësive) agrare në Shkup. Detyrat e kooperativave (bashkësive) agrare ishin të llojllojshme dhe kishin të bënin kryesisht me kujdesin për përparimin ekonomik dhe kulturor të kolonistëve. Mirëpo, detyrat themelore ishin: t'i praninin dhe t'i vendosnin kolonistët në shtëpitë e ndërtuara për ta, t'i ndërtonin shtëpi, t'u ndanin kredi ata vetë t'i ndërtonin, t'u ndanin vegla për punë, bagëti dhe farë, t'u siguronin ushqim deri te të korrjet e para, t'u mundësonin kolonistëve punësim, intervenonin te pushteti për nevoja të ndryshme të kolonistëve, të kujdese-shin për shëndetin e kolonistëve dhe që vdekshmëria, për shkak të ndërrimit të kushteve klimatike të jetës, të ishte sa më e vogël, të kujdese-shin për prosperitetin e kolonive të kolonistëve dhe të intervenonin te pushteti që të hapeshin puse për ujë, ujësjellës, rrugë, ura, shkolla, të bëhej meliorimi i tokës, sidomos me tharjen e moçaleve, të punonin në ngritjen e bujqësisë etj. Mirëpo, këto kooperativa arritën fare pak në këtë aspekt.⁴⁹

Sipas Ligjit mbi rregullimin e marrëdhënieve agrare në viset e përparshme të Serbisë dhe të Malit të Zi të 5. XII. 1931⁵⁰ u themeluan edhe gjyqet agrare (në rrethet ku zbatohet Reforma agrare) dhe Gjyqi i lartë agrar në Shkup, kishte për detyrë të përcaktonte dhe të shqyrtonte me procedurë të posaçme marrëdhëniet agrare. Gjyqet agrare qenë lëvizëse, shkonin prej një vendi në tjetrin.⁵¹

Në zbatimin e Reformës agrare dhe të kolonizimit në përgjithësi, e në rastin konkret në Kosovë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi, ishin të angazhuara edhe organet e tjera që do t'i përmendim më poshtë.

Ministria e bujqësisë deri në vitin 1929 s'ishte e angazhuar drejtpërdrejt në zbatimin e Reformës agrare dhe të kolonizimit. Detyrat e saj ishin të kujdesej për përparimin e ekonomisë tokësore në përgjithësi, për mirëmbajtjen dhe përparimin e rrjedhave të ujit, pastaj në mbikëqyrjen e punëve të llotarisë shtetërore dhe në përhapjen e shkencës dhe të propagandës bujqësore për futjen e metodave të reja në punën dhe në organizimin e ekonomisë.

⁴⁶ »Proleter« nr. 11/15. II 1930, Beograd, f. 3.

⁴⁷ Dr. Mr. Erić, v. c. 320.

⁴⁸ AJ, MAR, 96—24—77.

⁴⁹ Mr. Jusuf Osmani, *Bashkësitë (kooperativat) agrare në Kosovë në mes dy luftërave botërore*, »Kosova« nr. XIII, XII 1985, Prishtinë.

⁵⁰ »Gaz. zyrtare e Mbretërisë Jugosllave« nr. 285 — XVIII/5. XII. 1931.

⁵¹ AK, Kartoteka e zejtarëve, k. 1, nr. 10400 e 18. XII. 1937.

Kryente punët melioruese rreth vendbanimeve ose pjesëve të tokave të kufizuara për kolonizim.⁵²

Këtë Ministri e përbënin:⁵³ 1. Kabineti i ministrit; 2. Sektori për bujqësi, ku bënin pjesë: seksioni për lavërtari, seksioni për mësimin bujqësor, seksioni për administratë, seksioni për blegtori, seksioni për pemtari dhe vreshtari dhe seksioni për politikë agrare; 3. Seksioni për veterinari; 4. Drejtorati gjeneral i ujërave dhe 5. Sektori i kontabilitetit. Në kuadrin e këtyre seksioneve ekzistonin edhe disa nënseksione.⁵⁴

Siç theksuam më lart, pas shpalljes së diktaturës monarkofashiste suprimohet Ministria e Reformës Agrare dhe kompetencat e saj i merr Ministria e Bujqësisë, e cila pëson ndryshime edhe në kuadrin e saj, ku formohen seksioni për Reformën agrare me dy nënseksione: sektori për viset jugore dhe sektori për viset veriore. Në suazën e seksionit të përgjithshëm formohet edhe sektori financiar i Reformës agrare.

Në bazë të Dekretligjit mbi veprimtarinë dhe titullimin e disa sektorëve të Ministrisë së Bujqësisë,⁵⁵ kjo Ministri përfshinte: 1. Seksionin e përgjithshëm, ku bënin pjesë: sektori administrativ, personal, i kontabilitetit dhe kabineti i Ministrisë; 2. Seksioni për prodhimtarinë bimore (sektori për lavërtari, sektori për pemtari dhe vreshtari dhe sektori për mbrojtjen e bimëve); 3. Seksioni për blegtori (sektori për kaltari, sektori për gjedhtari, derra, dele dhe dhi me qumështari; sektori për shpezëtari, mendafshitari, bletari dhe rritjen e lepujve të butë; sektori për peshkim në ujërat e ëmbla dhe dete); 4. Seksioni për veterinari (sektori për shërbimin e brendshëm veterinar dhe sektori për shërbimin e jashtëm veterinar); 5. Seksioni për politikën agrare (sektori për politikën agrare, sektori për organizimin bujqësor, sektori për statistikën bujqësore; 6. Seksioni për Reformën agrare dhe punët agraro-juridike (sektori për viset veriore, sektori për viset jugore dhe sektori financiar).

Në kuadrin e sektorit të viseve jugore, ku bënte pjesë edhe Kosova, hynin edhe këto punë: hartimi i planit për zbatimin e kolonizimit të përgjithshëm, vendosja për të gjitha ato çështje të kolonizimit të cilat, sipas Ligjit mbi kolonizimin e viseve të reja jugore, ishin mbetur në kompetencën e Ministrisë, mbikëqyrja supreme e kolonizimit dhe ndarja e tokës vendësve, të cilën e bënte bani për territorin e Banovinës së vet, krijimi i kushteve të volitshme për kolonizim dhe ngritja kulturore dhe ekonomike e të interesuarve agrarë (kolonistëve, vullnetarëve dhe vendësve), zbatimi i parimeve themelore të Reformës agrare sa i përket blerjes së tokave private, ndihma materiale dhe me mjete të tjera për shoqatat e ko-

⁵² Anatasije Urošević *Spomenica 20 Godišnjice oslobođenja Južne Srbije, 1912—1937*, Shkup, 1937.

⁵³ Kjo Ministri gjatë kohës së ekzistimit ka pësuar ndryshime në pikëpamje organizative.

⁵⁴ «Gaz. zyrtare e Mbretërisë së Jugosllavisë» nr. 295—CII, c 24. XII. 1930.

⁵⁵ Almanah Kraljevine SHS, II, 1927—28, Zagreb, f. 65—66. Në Almanah Kraljevine SHS, 1921—22, f. 55, ekziston formë tjetër organizative e kësaj Ministrie.

lonistëve dhe për të interesuarit e tjerë agrarë dhe lidhja e tyre në marrëveshje me drejtoritë e banovinës, mbikëqyrja supreme e vepërimtarisë së tyre, mbikëqyrja supreme për dhënien e drejtë të certifikatave, të cilat i lëshonin organet kompetente sipas nenit 4 të Rregullorës mbi ekzekutimin e Ligjit mbi lëshuarjen e tapive dhe punët agraro-juridike nëse nuk zgjedhen në lutjen e fundit të Drejtoratit të banovinës.⁵⁶

Ministria e Bujqësisë, sipas Ligjit mbi kolonizimin e viseve jugore, zbaton kolonizimin në të ashtuquajturat »vise jugore« nëpërmjet dy organeve ekzekutive, Drejtoratit suprem të Reformës agrare, i cili ndante tokën, dhe Lidhjes së kooperativave agrare, e cila kujdesej për përparimin e tyre kulturor dhe ekonomik.

Ministria e Drejtësisë. Në kompetencën e kësaj Ministrie bënte pjesë udhëheqja supreme e të gjitha punëve administrative gjyqësore, si dhe udhëheqja supreme në ato institucione për të cilat ishte kompetente dhe ishin nën mbikëqyrjen e saj. Kjo Ministri kujdesej për publikimin e ligjeve, hartonte projektet, plotësimet dhe ndryshimet e ligjeve, mbikëqyrte punën e gjyqeve dhe të enteve ndëshkimore në zbatimin e rregullave të punës. Përveç kësaj, kujdesej edhe për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga lufta. Ministria e Drejtësisë e ruante edhe vulën shtetërore, të cilën ia linte në dispozicion mbretit gjatë vulosjes dhe nënshkrimit të tij.

Ministria e Drejtësisë përbëhej prej⁵⁷ Kabinetit, seksionit administrativ, seksionit për hartimin e projekteve ligjore, seksionit për entet ndëshkimore, seksionit për sekuesturë, seksionit të kontabilitetit, seksionit për dëmin e shkaktuar nga lufta, seksioneve të posaçme për territoret e Banatit, të Baçkës dhe të Baranjës, për Kroaci dhe Sllavoni, për Dalmaci dhe Sllaveni, për Bosnjë e Hercegovinë dhe për Mal të Zi.⁵⁸

Përkritazi me zbatimin e Reformës agrare dhe të kolonizimit në Kosovë, në kompetencën e kësaj Ministrie ishte hartimi i projekteve të ligjeve, dekretligjeve, rregulloreve etj. për Reformën agrare dhe kolonizimin. Kjo Ministri mbante korrespondencë me ministritë e tjera ku shkëmbenin mendime dhe propozime rreth ligjeve, të cilat kishin të bënin me ministritë përkatëse.

Ministria e Drejtësisë interpretonte dispozitat ligjore të të interesuarve agrarë, institucioneve agrare, ministrive të ndryshme dhe organeve të tjera, të cilat, veç të tjerash, kishin të bënin me kolonizimin agrar, lirimin e kolonistëve nga tatimi, zhdukjen e marrëdhënieve agrare, ndarjen e tokës, kompensimin e dëmit, marrjen e pronave etj. Në kompetencën e Ministrisë së Drejtorisë ishte edhe mbikëqyrja e punës së organeve të jurisprudence, nëpërmjet urdhërësave dhe udhëzimeve, sidomos përkritazi me kontestet agrare ndërmjet vendësve e kolonistëve dhe ndërmjet vetëm kolonistëve etj.⁵⁹

⁵⁶ AJ, Ministria e Bujqësisë 67, k. 1. fas. 12, 1930.

⁵⁷ Almanah Kraljevine SHS, II, Zagreb, 1927—1928, f. 44—45; Në Almanah Kraljevine SHS, flet. I, 1921—1922, f. 79, ekziston strukturë tjetër e përbërjes së kësaj Ministrie.

⁵⁸ Kjo Ministri gjatë ekzistimit të vet ka pësuar ndryshime.

⁵⁹ AJ, Ministria e Drejtësisë së Mbretërisë Jugosllave, 63, Inventari.

Ministria e Financave. Detyrat e saj ishin: hartimi i propozimit të buxhetit shtetëror dhe i të gjitha ligjeve financiare, grumbullimi i të ardhurave shtetërore dhe shpërndarja e tyre, mbikëqyrja e të gjitha institucioneve financiare, përfaqësimi i personave privatë para pushtetit, i pronësisë shtetërore dhe i interesave materiale shtetërore, vendosja për të gjitha çështjet e valutave dhe lëshimi në qarkullim i të hollave të letrës dhe të metalta, udhëheqja me të mirat shtetërore dhe borxhet e shtetit, udhëheqja e kadastrës dhe mbikëqyrja e financave vetjake.

Në kuadrin e Ministrisë së Financave ekzistonin: Kabineti, Inspektorati gjeneral, tetë drejtorate gjenerale: i kontabilitetit shtetëror, tatimit të drejtëpërsëdrejtë, tatimit indirekt, doganës, borxheve shtetërore, avokaturës shtetërore, të mirave shtetërore dhe e kadastrës.⁶⁰

Ministrisë së Financave (seksionit për borxhet shtetërore dhe kreditë shtetërore) iu besua pagesa e kompensimit për tokat që iu morën pronarëve sipas »Ligjit mbi rregullimin e marrëdhënieve agrare në krahinat e përparshme të Serbisë Jugore dhe të Malit të Zi«, të dt. 5. XII. 1931, mirëpo, për këtë qëllim u themelua Fondi i posaçëm pranë Bankës shtetërore hipotekare.⁶¹

Rëndësi të posaçme për Reformën agrare dhe kolonizimin kishte sektori i kadastrës, përkatësisht Drejtorati gjeneral i kadastrës. Në këtë sektor gjendeshin kryesisht këto materiale:⁶² për matjen dhe parcelimin e tokës agrare, lidhja dhe lejimi i kontratave për matjen e saj nga ana e gjeometrave civilë dhe të të interesuarve agrarë, për matjen e tokës agrare, punët kadastrale lidhur me tokën e goditur nga Reforma agrare, evidencat kadastrale të marrëdhënieve pronësore — poseduese dhe librat për pronën tokësore, kulturën, klasën dhe matjen e tokës, tatimi për tokën, toka e goditur nga Reforma agrare në zonën kufitare, lirimi nga tatimi i autokolonistëve, kolonistëve, optantëve dhe i vullnetarëve, të huajve dhe organizatave të ndryshme. Materiale (lutje me certifikata të ndryshme, tapi, kontrata mbi shitëblerjen, fletëposeduese, vendime, plane, procesverbale, aktvendime, raporte, parashtresa, aktgjykime, ankesa dhe korespondenca) për kërkesat e veçanta të kolonistëve-autokolonistëve për lirin nga pagesa e të gjitha tatimeve të drejtëpërdrejta shtetit për 10 vjet, si dhe prej të gjitha tatimeve të banovinës e të komunave, pastaj prej tatimeve të pavarura për 5 vjet për tokat e blera e në bazë të Ligjit mbi kolonizimin e viseve jugore. Shënimet për pronën e patundshme (mënyra e fitimit të së drejtës dhe për këmbim, shitja, dhënia në qesim, dhënia për shfrytëzim dhe përdorim, evidenca për nxjerrjen e tapisë dhe tokave kontestuese.

Materiale: (korespondenca, aktgjykime dhe primanota) lidhur me pagesën nga Fondi për likuidimin e marrëdhënieve agrare, kompensimin e caktuar e të hollave pronarëve të mëdhenj në emër të dëmit për tokën e marrë, e në bazë të aktgjykimit të gjyqeve agrare të rrethit dhe Gjyqit të lartë agrar në Shkup.

⁶⁰ Almanah Kraljevine SHS, III, 1927—1928, f. 58—61.

⁶¹ Dr. M. Eriq, v. c. f. 320.

⁶² AJ, Ministria e Financave e Mbretërisë Jugosllave, 70, Inventari.

Raportet e Bankës shtetërore hipotekare dhe primanotat lidhur me kthimin në Fondin për likuidimin e marrëdhënieve agrare, kompensimi i dëmit të ish — pronarëve në territorin e ashtuq. »Serbi jugore«, pasi kishin shkuar në Turqi e gjetiu dhe nuk u ishin dërguar të hollat.

Materialet (regjistrat, raportet dhe primanotat) lidhur me pagesën e kisteve të arritura nga punuesit e tokës të cilëve iu është caktuar me Ligjin mbi rregullimin e marrëdhënieve agrare nga ana e gjyqeve agrare, për buxhetin etj.

Ministria e Punëve të Brendshme, përkatsisht pushteti policor, ishte gjithashtu e angazhuar në komisionin për kufizimin e komplekseve për kolonizim dhe në Këshillin këshilldhënës për kolonizim. Në fillim, në bashkëpunim me organet e veta dhe me prefektin e rrethit, bënte parcelimin dhe ndarjen e tokës. Detyrë e pushtetit policor ishte që t'u dilnin në ndihmë organeve për zbatimin e Reformës agrare dhe kolonizim, t'u ndihmonin kolonistëve gjatë ardhjes, vendosjes, të kuqdeseshin për sigurimin e tyre, t'i mbronin nga sulmet eventuale të kaçakëve, që në çdo çast të ishin pranë kolonistëve etj.⁶³ Kjo Ministri angazhoi policinë dhe xhandarmerinë që të bënte presion mbi elementin shqiptar që të shpërngulej, në përputhje me synimet e Ministrisë së Punëve të Jashtme.⁶⁴ Njëherësh, kërkohet nga kjo Ministri që t'u urdhëronte autoritetet policore të mos i pengonin nëpunësit agrarë në zbatimin e Reformës agrare.⁶⁵ Për këtë Ministri dhe ministritë e tjera nuk ka nevojë të jepet struktura organizative e tyre.

Ministria e Ushtrisë dhe e Detarisë. Nëpërmjet organeve më të ulta të saj, dha kontribut të posaçëm në zbatimin e Reformës agrare e të kolonizimit. Ajo bënte propagandë për kolonizim sa më të shpejtë dhe më të suksesshëm në Kosovë dhe në viset e tjera, për shpërnguljen e shqiptarëve në Turqi dhe Shqipëri, përcolli kolonistët dhe u kujdes për mënjanimin e pengesave rreth kolonizimit dhe shpërnguljes. Informonte për situatën politike, rezistencën kundër kolonizimit, masat që duhej të ndërmerreshin. Informohej për propagandën dhe aktivitetin komunist, që ishte kundër marrjes së padrejtë të tokës prej vendësve, kundër shpërnguljes së shqiptarëve, turqve etj. në Turqi dhe Shqipëri. Gjithashtu kjo Ministri ndiqte dhe i kundërvihej propagandës shqiptare kundër kolonizimit, reformës agrare dhe shpërnguljes.⁶⁶ Këtë Ministri e angazhonte Ministria e Punëve të Brendshme që të shkaktonte sa më shumë çrregullime, në mënyrë që organet e saj të intervenonin.⁶⁷

Ministria e Punëve të Jashtme kishte për detyrë t'i kundërvihej propagandës së shoqërive të ndryshme shqiptare dhe individëve, siç ishin Hasan Prishtina, tre priftërinjtë — Don Xhon Bisaku, Don Shtjefën Kurti nga Prizreni dhe Don Luigj Gashi nga Shkupi etj. që i ishin drejtuar Shoqërisë së kombeve në Gjenevë etj. Pastaj

⁶³ AJ, Ministria e Punëve të Brendshme e Mbretërisë Jugosllave, (MUP), 14.

⁶⁴ Dr. H. Bajrami, v. c. 53.

⁶⁵ E njëjtë, 54.

⁶⁶ Arkivi i Institutit historik ushtarak, Beograd (AVII), Popisnik 17.

⁶⁷ Dr. H. Bajrami, v. c. 53.

ajo para opinionit botëror e arsyetonte Reformën agrare dhe kolonizimin si masë të nevojshme ekonomike« si dhe shpërnguljen e shqiptarëve e të myslimanëve të tjerë gjoja me »dëshirë« dhe »vullnetin« e tyre. Një prej detyrave kryesore të saj ishte nënshkrimi i konventës me Republikën e Turqisë për shpërnguljen e shqiptarëve dhe të turqve në Turqi.⁶⁸

Ministria e Pylltarisë dhe e Xehetarisë, u jepte kolonistëve material ndërtimor, lëndë dhe gurë për ndërtimin e shtëpive dhe dru për djegie, pastaj ndihmë në pyllëzimin e viseve të zhveshura etj.

Ministria e komunikacionit e kishte për detyrë t'u jepte kolonistëve bileta pa pagesë për bartjen e familjeve të tyre, inventarit, bagëtive e të tjera nga vendlindja deri te vendi i vendosjes për kolonizim.

Ministria e Arsimit kujdesej që nëpërmjet mësuesve të vet të bënte propagandë për kolonizim të suksesshëm dhe për shpërnguljen, pastaj për arsimimin e kolonistëve, ngritjen e shkollave nëpër vendbanime, sidomos të atyre të kolonistëve, hapjen e shkollave lëvizëse të amvisërisë etj.⁶⁹

Ministria e Ndërtimtarisë kujdesej për ndërtimin e rrugëve dhe për lidhjen e vendbanimeve të kolonistëve me rrugët kryesore, hapjen e puseve ose të ujësjellëseve nga kretitë etj.⁷⁰

Ministria e Politikës Socialiste dhe e Shëndetit Popullor interesohej që në vendbanimet e kolonistëve ose në afërtësi të tyre të ndërtoheshin ambulancat ose stacionet shëndetësore, të themeloheshin kooperativat shëndetësore, për sigurimin e kolonistëve, mjekim dhe shërim pa pagesë ose më të lirë në spital dhe gjatë kontrollimit mjekësor etj.⁷¹

Edhe pse organet e theksuara më lartë ishin të obliguar t'i kryenin shumë detyra rreth kolonizimit dhe reformës agrare ata disa prej tyre me sukses i realizonin ndërsa disa të tjera nuk ia arritën qëllimit.

Dogana shtetërore jepte kontributin e vet duke i liruar kolonistët e ardhur nga shtetet e huaja nga dogana etj.

Organet e Jurisprudencës — gjyqet komunale, të rrethit, të shkallës së parë, të qarkut, gjyqet agrare, gjyqi i apelacionit në Shkup etj. qenë përfshirë në zbatimin e Reformës agrare dhe të kolonizimit. Ndër të tjera, këto gjyqe zgjidhnin kontestet e ndryshme gjyqësore në mes të kolonistëve dhe vendësve, bënin pa pengesë regjistrimin e bashkësive (kooperativave) agrare, pastaj detyrë e tyre ishte që të mos bënin pengesa rreth kolonizimit, të lëshonin

⁶⁸ Arkivi i Sekretariatit të Punëve të Jashtme (DASIP), Beograd. Dokumentet e fondit »Društvo naroda u Zenevi« dhe MPJ.

⁶⁹ AJ, Ministria e Financave e Mbretërisë Jugosllave, Beograd, (MF) 70—56—104. Procesverballi i mbajtur në Konferencën e Ministrisë së Bujqësisë me përfaqësuesit e Lidhjeve të bashkësive agrare dhe kolonistëve, ku janë shqyrtuar çështjet të cilat është dashur të zgjidhen në interes të ngritjes ekonomike të kolonistëve dhe vendbanimeve etj. në Beograd më 29—30, I, 1940.

⁷⁰ E njëjtë.

⁷¹ E njëjtë.

certifikata të ndryshme, vërtetime, të bënin sa më shpejt dhe pa pengesë pronësimin e tokës për kolonistë dhe të lëshonin tapi, të bënin bartjen dhe vërtetimin e kontratave shitblerëse në mes të kolonistëve, sidomos të autokolonistëve dhe personave të shpërngulur në Turqi dhe Shqipëri për tokën e blerë etj. Detyra e gjyqeve agrare dhe e Gjyqit të lartë agrar në Shkup ishte që sa më parë t'i zgjidhnin marrëdhëniet agrare (çifligare, me qesim, arendatore, të beqarisë etj.), marrëdhëniet rreth shitë blerjes së tokës etj.

Oborri mbretëror. Me rëndësi për Reformën agrare dhe kolonizimin ishte edhe Oborri mbretëror. Projekti i parë për rregullimin e Oborrit mbretëror u nxor më 1921, mirëpo, Ligji i parë mbi rregullimin e Shtëpisë civile të mbretit u nxor 10 vjet më vonë. Që atëherë ai ekzistonte si ent i veçantë dhe i pavarur që kryente veprimtari të caktuar. Në të vërtetë, sipas Ligjit të 28. XI 1931, me Shtëpitë civile të mbretit qeveriste Ministri i Oborrit, të cilin, me propozimin e Këshillit ministror, e emëronte mbreti.⁷²

Në aspektin organizativ Shtëpia civile ndahej në tre sektorë: 1. Zyra e mbretit (nënsektori politik, administrata, biblioteka dhe arkivi mbretëror; 2. Marshalati dhe 3. Drejtoria mbretërore.

Në kompetencën e Zyrës mbretërore bënin pjesë: pranimit, marrja dhe ekspeditimi i të gjitha shkresave të cilat i lëshonte mbreti, kurse në sferën e veprimtarinë e Marshallatit bënin pjesë punët rreth protokollit, ceremonialit, audicionit dhe udhëtimit. Strukturë më të zhvilluar organizative kishte Drejtoria mbretërore. Atë e përbënin 14 nënsektorë, shërbime, drejtorate. Si njësi e veçantë organizative e lidhur drejtpërsëdrejti në Drejtorinë mbretërore ishte Drejtoria e fondit mbretëror.

Më 1935, pas vrasjes së mbretit Aleksandër, u formua edhe Zyra e mbretëreshës Maria, e cila merrej kryesisht me dhënien e ndihmës qytetarëve të varfër.

Oborrit mbretëror i drejtoheshin persona të ndryshëm — kolonistë dhe vendës nëpërmjet lutjeve dhe ankesave për ndarjen e tokës, mosmarrjen e tokës, i shpallnin falënderime për tokën e ndarë, i dërgonin raporte të ndryshme etj.

Press byroja qendrore (Centralni press biro — CPB) u themelua me ligjin e Press byros qendrore të 18. IV. 1928.⁷³ Me Ligjin mbi përparimin e Kryesisë së Këshillit Ministror të 1. V. 1929,⁷⁴ Press byroja qendrore ishte një prej sektorëve të Këshillit ministror. Me paragrafin 11 të po këtij ligji, CPB përbëhej prej tre nënsektorëve: administrativ, informativ dhe të publicistikës.

Me paragrafin 16 CPB-së i jipej mundësia të kishte korespondentët e vet në vend dhe jashtë vendit. Me këtë ligj u caktuan kompetencat e disa shërbimeve. Me rregulloren rreth punëve të CPB-së u përcaktuan kompetencat e disa sektorëve, si dhe të vetë CPB-së. Nëpërmjet organeve të veta ajo grumbullonte informata nga shtypi i jashtëm dhe i brendshëm, lajme të natyrës politike, financiare dhe ekonomike në vend dhe jashtë vendit. Me punime letrare dhe gazeta informonte opinionin e jashtëm dhe të brendshëm për

⁷² AJ. Shënimi historik — inventari sumar i Fondit »Dvor« 74; Informator Arhiva Jugoslavje, 1982, Beograd.

gjendjen në vend. Korespondentët e CPB ishin të detyruar të jepnin dhe të përhapnin informata të sakta për gjendjen në vend, dhe sipas nevojës, të jepnin copa të prera të gazetave origjinale ose të përkthyra që kishin të bënin me çështje të ndryshme në vend sidomos me zbatimin e Reformës agrare dhe kolonizimin në Kosovë.⁷⁵

Në përgjithësi, puna e organeve për zbatimin e Reformës agrare dhe të kolonizimit nuk ishte në nivelin e duhur. Punën e organeve të ulta e kritikuan organet e larta ose personat e ndryshëm në opozitë, partitë politike etj. Përkitazi me këtë, në referatin e Tanasije Gj. Gjiniqit, deputet i popullit, me titull »Përshtypjet mbi gjendjen e përgjithshme në vend«, i muajit mars 1938, Beograd, theksonte: »Klasifikimi i kryer i tokës në territorin e Banovinës së Vardarit gjatë vitit 1928/29 në të shumtën e rasteve është bërë në mënyrë jo të drejtë, joprofesionale, me sy pa hulumtimin e tokës dhe pa marrë parasysh kushtet klimatike. Toka nuk është klasifikuar sipas bonitetit të vërtetë. Ngarkimi jo i drejtë me tatim, pagesa e tatimit edhe për tokën të cilën e ka marrë shteti, dhënia e tokës në qesim për të cilën paguajnë tatim, shkatërrimi sistematik i bujqve, nga shtëpiaku po krijohen rrugaç e proleterë, po shkatërrohen ekonomitë fshatare. Pasojë e kësaj është se bujku po ik nga toka, nga shtëpia ku po bëhet punëtor i vrazhdë«.⁷⁶ Ndërsa, në gazetën »Politika«, ndër të tjera, thuhej: »toka po u jepet të privilegjuarve, kurse njerëzit e urtë dhe të varfër ende presin për ndihmë nga ana e shtetit.«⁷⁷ Administrata agrare është e paaftë, pa kurrfarë dije dhe i mungon intelegjencia. Është ndarë toka pa kurrfarë kriteri, pa elaborate teknike, me sy, u është dhënë atyre të cilët e kanë shtrirë dorën, kurse shumë e kanë marrë vetë. Me tokë janë bërë spekulime, 40% të tokës nuk e kanë marrë bujqit, por spekulantët, jopunëtorët, parazitët. Ka raste kur vendësit, në llogari të spekulimeve dhe të parazitëve, e kanë humbur edhe atë copë të tokës të cilën e kishin«.⁷⁸ Edhe gazeta »Proleter« i thekson malverzimet rreth zbatimit të Reformës agrare dhe pushtetit agrar. Sipas saj, në Maqedoni dhe në Kosovë Diktatura monarko-fashiste vazhdon politikën agrare serbomadhe me mjete terrori të papara. Toka u merret me forcë maqedonasve dhe shqiptarëve dhe u jepet vrangelovcëve — bellogardistëve rus dhe vullnetarëve serbomëdhenj. Përzinën me pushkë, mitraloza dhe bomba mijëra familje shqiptare nga vatrat e tyre.⁷⁹ Kurse në gazetën »Kosovske novine« të datës 5. III. 1937 nr. 8, me titull »Reforma agrare në Serbinë Jugore dhe kosovarët — serbët vendës«, autor i të cilës është Millorad Gjukiq, pensionist, theksonte se po punohet pa plan dhe pa kurrfarë sistemi konkret. Bëhen shumë gabime, nuk merren parasysh nevojat e serbëve vendës. Caktohen nëpunës njerëzit e pakualifikuar. Ka gabime në ndarjen e tokës, ka propagandë partiake dhe interes në llogari të tokës

⁷⁵ »Gazeta zyrtare e Mbretërisë SKS« nr. 280 CXII/1929.

⁷⁶ »Gazeta zyrtare e Mbretërisë SKS« nr. 105 XLII/1929.

⁷⁷ AJ. Fond: CPB. 38.

⁷⁸ AJ, Fond Milan Stojanović, 37, f. 39.

⁷⁹ »Politika« nr. 4774/9. VIII. 1921, Beograd.

⁸⁰ »Agrarni pregled« nr. 1/1924, Shkup.

⁸¹ »Proleter« nr. 11/15. II. 1930.

shtetërore, ka filluar t'iu jepet tokë atyre që nuk janë bujqë. Toka nuk po u jepet serbëve vendës, të cilët edhe më tutje po mbesin të varfër.⁸⁰ Pastaj gazeta e kohës »Vreme« jep thekse nga fjalimi i deputetëve I. Shumenkoviç, T. Arsiq, S. Vukosavljeviç, D. Qiçeviç, G. Bozhoviç e të tjerë, nga klubi demokratik, të të ashtuquajturës »Serbi Jugore«, ku shqyrtohet gjendja në këtë pjesë të vendit. Theksohet se në ato vise gjendja është e padurueshme. Theksohet nevoja e përmirësimit të kushteve, e forcimit të kontrollit të nëpunësit, të cilit po punojnë shumë keq, posaçërisht pushteti policor.⁸¹

Puna e organeve për zbatimin e Reformës agrare dhe të kolonizimit në Kosovë zgjati 23 vjet. Reforma agrare nuk u krye. Kjo zgjatje dëshmon për mospërgatitjen e organeve shtetërore për zbatimin e saj. Nuk dihej sa kishte tokë dhe cilësia e saj, pastaj numri i familjeve dhe në cilin vend mund të vendoseshin.⁸² Në Kosovë organet e zbatuan të kundërtën. Së pari e filluan kolonizimin e pastaj, vetëm në vitin 1933, filluan t'i zgjidhnin problemet agrare ekzistuese. Kolonizimin e bënë në Kosovë, e cila në atë kohë në pikëpamje agrare ishte gati më e dendura në krahasim me disa vise të tjera të vendit.

Punën e organeve për zbatimin e Reformës agrare dhe të kolonizimit të padrejtë në Kosovë dy luftërave botërore e shqyrtoi dhe e përmirësoi pushteti i ri popullor i Jugosllavisë socialiste, menjëherë pas çlirimit të vendit, duke bërë revizionin e saj.

Dr. Jusuf Osmani

LES ORGANES POUR L'APPLICATION DE LA REFORME AGRARE ET DE LA COLONISATION DE LA KOSOVA ENTRE LES DEUX GUERRES MONDIALES

R é s u m é

Les organismes d'état et l'administration du Royaume des Serbes — Croates — Slovènes étaient engagés directement ou par d'autres manières pour l'application de la réforme agraire et de la colonisation de la Kosova et d'autres régions du pays, à partir des organismes d'état les plus élevés jusqu'aux plus bas locaux. Ces organismes furent constitués au début de 1919. L'organisation, la structure et les compétences de ces organismes ont subi des changements durant leur fonctionnement pendant cette période.

Pour l'application de la réforme agraire et de la colonisation furent nommées des commissions agraires, des conseils, ensuite des directinos agraires départementales (pour le territoire de la Kosova à Prizren, à Pejë, à Gjakovë, à Vuçiternë, à Mitrovicë, à Prishtinë (Ferizaj). La Direction Suprême de la réforme agraire à Shkupi, puis le Ministère de la réforme agraire, respectivement le Ministère d'agriculture comme organisme suprême pour l'application de la réforme. Cependant, il y avait encore d'autres organismes d'état qui contribuaient dans ce sens.

⁸⁰ »Kosovske novine« nr. 8/5. III. 1937.

⁸¹ »Vreme« nr. 293/13. X. 1922, Beograd.

⁸² Dr. M. Obradoviç, v. c. 206.